



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Raportim Vjetor

Përpara Komisionit për Ekonominë dhe Financat
Kuvendi i Shqipërisë, Tiranë

Veprimtaria e AMF-së gjatë vitit 2015

Enkeleda Shehi,
Drejtoreshë e Përgjithshme Ekzekutive

18 Korrik, 2016

Znj. Enkeleda Shehi, Drejtoreshë e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) paraqet raportin vjetor përpara Komisionit për Ekonominë dhe Financat, të Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të neneve 3, 13, 14, 16 dhe 28 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar.

Kryetar i Komisionit, z. Braçe; Zëvendëskryetar i Komisionit, z. Bode; Zonja e Zotërinj deputetë anëtarë të Komisionit,

Në përmbushje të detyrimit ligjor paraqes sot raportin vjetor mbi veprimtarinë e AMF-së¹ të zhvilluar gjatë vitit 2015.

Që në fillim dëshiroj të theksoj se në vëmendjen tonë për programimin e punës për vitin 2015 kanë qenë kërkesat e paraqitura nga Kuvendi në rezolutën mbi vlerësimin e veprimtarisë së AMF-së për vitin 2014, zbatimi i rekomandimeve të Raportit të Progresit dhe të FSAP të cilat shtrihen për të gjitha tregjet që mbikëqyr e rregullon AMF. Siç kemi theksuar edhe gjatë

¹ Raporti Vjetor, 2015, AMF.

raportimit të vitit të kaluar një pjesë e detyrave janë të natyrës afatmesme, si dhe afatgjatë, e për pasojë janë trajtuar dhe vitin e kaluar por do të trajtohen edhe për disa vite në vijim.

Veprimtaria e AMF-së gjatë vitit 2015 mund të themi se u përqëndrua në këto drejtime kryesore:

- në aspektet e ristrukturimit të AMF, në kuadër të zbatimit të ligjit të ri të AMF me konfigurimin e Bordit të ri, u miratua struktura e re organizative dhe tabela e re e pagave dhe shpërblimeve;
- në përgatitjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri të sigurimeve dhe risigurimeve si dhe në përshatjen e rregulloreve në zbatim të ligjit të ri të AMF (18 akte);
- në zbatimin e axhendës së projekteve të asistencës teknike të BB kryesisht në fushën e pensioneve dhe atë të sigurimeve;
- në plotësimin e rekomandimeve të FSAP-it të cilat shtrihen për të gjitha tregjet që mbikëqyr e rregullon AMF dhe i përkasin një periudhe afatmesme, siç u theksua dhe më lart.

Në fjalën time do të përqendrohem në tre shtylla kryesore: (i) zhvillimet e mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregjeve financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së, (ii) funksionimi i vetë institucionit të AMF-së, dhe (iii) objektivat dhe projektet për vitin 2016.

1. Tregjet financiare nën mbikëqyrje

Tregjet e sigurimeve, të kapitalit dhe fondeve të investimeve, si dhe të fondeve private vullnetare të pensioneve, që njihen me termin tregjet financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së, kanë vijuar prirjen e tyre për zgjerim. Në vitin 2015 totali i aktiveve në këto tregje arriti në rreth 95.7 miliardë lekë (rreth 697 milionë euro), me një rritje prej 7% kundrejt vitit 2014 (89 miliardë lekë). Për rrjedhojë, edhe kontributi i këtyre tregjeve në ndërmjetësimin financiar është rritur ndjeshëm. Treguesi i aktiveve gjithsej ndaj PBB-së për vitin 2015 arriti në nivelin më të lartë të vërejtur deri më sot prej 6.7%. Për të kuptuar më mirë këtë dinamikë, mjafton të kujtojmë që ky tregues në vitin 2014 arriti 6.4%, dhe 5.36%, 2.75% përkatësisht në vitet 2013 dhe 2012.

Struktura e tregjeve në vitin 2015 konfirmoi ndryshimin strukturor të vërejtur në tre vitet e fundit. Kështu, tregu më i madh për t'u mbikëqyrur nga pikëpamja e aktiveve mbeti tregu i fondeve të investimeve. Pësia e këtij tregu në vitin 2015 në tregjet financiare që mbikëqyr AMF, arriti në 70.2% me një ulje të lehtë nga viti 2014 ku pësia e këtij tregu ishte 71.4% (dhe duke ardhur në vlerat e vitit 2013 ku pësia ishte 69%).

Në fund të vitit 2015 rezultojnë 438 licenca për ushtrim veprimtarie në tregjet që mbikëqyren nga AMF. Nga ky numër 59 janë licenca për shoqëri, përfshirë edhe bankat; 5 licenca janë për

fonde pensioni dhe investimi dhe 374 licenca janë për individë, profesionistë të fushave nën mbikëqyrje të Autoritetit.

Duke u ndalur në veçanti në secilin prej tregjeve do të theksoja:

2. Tregu i sigurimeve

Tregu i sigurimeve, në raport me tregjet e tjera financiare, gjatë katër viteve të fundit po paraqet një **situatë të stabilizuar dhe me një rritje të qëndrueshme**, me vëmendje kryesore në produktin e sigurimit të detyrueshëm motorik dhe me nevojën për rritjen e shkallës së penetrimit, nëpërmjet zgjerimit të tregut të produkteve vullnetare. Shkalla e penetrimit megjithëse është rritur në 0.98% në vitin 2015 krahasuar me 0.83% në vitin 2014, mbetet ende hapësirë për të rritur këtë tregues në nivelin e vendeve të rajonit. (*Kosova 1.39%, Mali i Zi 2.15%, Maqedoni 1.51%, Serbi 2.15%*)

Totali i aktiveve në vitin 2015 është rreth 1.92 % e PBB-së, pothuaj sa një vit më parë (1.8%). Ndërsa pesha kundrejt totalit të aktiveve të tregjeve financiare nën mbikëqyrje, ka arritur në 29%, nga 27% që ishte një vit më parë.

Në të njëjtën tendencë si në vitin 2014, brenda tregut të sigurimeve, në ndryshim nga pozicionimi i tij kundrejt tregjeve të tjera financiare, vërehet që, *vëllimi i primeve të shkruara bruto u rrit, kryesisht si rrjedhojë e rritjes së nivelit të primit të produktit të sigurimit të detyrueshëm motorik*. Ky zhvillim ishte rrjedhojë e masave në vijimësi që u ndërmorën për të stabilizuar primet e shiçjes në treg dhe për të mos i lënë të ndikoheshin nga konkurrenca e ashpër, fenomen i cili rrezikonte rezervat e shoqërive dhe dëmtonte procesin e pagimit të dëmeve.

Në vitin 2015 vëllimi total i primeve të shkruara bruto arriti në 14.086 miliardë lekë (100.80 milionë euro), duke u rritur me 21.18% krahasuar me vitin 2014². *Struktura e tregut, përgjithësisht vijon të ketë të njëjtin profil të vërejtur në vite, por me përforcim në tiparin e sigurimeve të detyrueshme*. Ndërsa nga pikëpamja e numrit të shoqërive operuese në këtë treg, gjatë vitit 2015, nuk pati ndryshime. Sigurimet e jo-jetës përbëjnë 92.70% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto në këtë treg dhe 60.23% e përbëjnë ato të detyrueshme. Primet e shkruara bruto të jo-jetës gjatë vitit 2015 u rritën me 23.20%.

Rritja e tregut të sigurimeve është e ndikuar kryesisht nga dinamika e rritjes së sigurimit të detyrueshëm motorik, i cili shënoi rritje me rreth 22.50% krahasuar me vitin 2014 dhe solli pjesën më të madhe të të ardhurave, ose 64.96% të totalit të primeve të shkruara bruto të

² Krahasimi është bërë me shifrat e raporteve të audituara të vitit 2014.

sigurimeve të jo-jetës. Në sigurimin e detyrueshëm motorik, portofoli me rritjen më të madhe rezultoi MTPL e brendshme, me rritje prej 27.52% krahasuar me 2014. Primi mesatar për sigurimin e detyrueshëm motorik në Shqipëri është afërsisht 109 Euro nga 94 Euro që ishte ky nivel primi në vitin 2014. Duke u krahasuar me vendet e rajonit konstatojmë që Shqipëria ka një nivel primi më të lartë se Maqedonia (88 Euro) dhe Kroacia (102 Euro) por më të ulët se Kosova (137 Euro) dhe Bosnia dhe Hercegovina (145 Euro).

Lidhur me shkallën e përdorimit të produkteve të sigurimit nga popullsia, në vitin 2015, primi për frymë ishte mesatarisht 4,880 lekë (34.92 euro), me një rritje prej 831.36 lekë krahasuar me një vit më parë. Primi për frymë në sigurimin e jo-jetës për vitin 2015 ishte mesatarisht 4,519 lekë.

Raporti dëme/prime për tregun e sigurimeve të jo-jetës në 31.12.2015 rezulton në vlerën 38.75% nga 35.75% që ishte 31.12.2014. Gjatë vitit 2015 u paguan rreth 3.64 miliardë lekë dëme (26.06 milion euro), ose rreth 28.30% më shumë se në vitin 2014. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimeve motorike me rreth 2.2 miliardë lekë (15.75 milion euro), apo 60.43% të totalit.

Por paralelisht me stabilizimin e primeve të shitjes së produktit MTPL në treg, është punuar edhe me stabilizimin e procesit të pagimit të dëmeve, sidomos të dëmeve të prapambetura në kuadër të dëmeve që trajtohen nga Byroja Shqiptare e Sigurimit (BSHS).

Në vitin 2015 AMF monitoroi zbatimin e masës stabilizuese që lidhet me *përcaktimin e nivelit të financimit të fondit të kompensimit në masë të mjaftueshme për të përballuar pagesat e dëmeve të prapambetura*. Kështu, në vijim të vendimit të Bordit të AMF-së të vitit 2014 mbi Fondin e Kompensimit, në vendimin e ri të vitit 2015 (nr. 12, datë 30.03.2015) u përcaktua që:

- fondi i kompensimit për vitin 2015 për shlyerjen e detyrimeve për pagesat e dëmeve pezull deri më 31.12.2013 është në vlerën 450 milionë lekë;
- fondi i kompensimit për vitin 2015, me qëllim pagesat e dëmeve me ngjarje sigurimi nga data 1 janar 2014 e në vazhdim, krijohet duke filluar minimalisht nga vlera 20 milionë lekë, dhe i shtohet pjesës së pakonsumuar të fondit të kompensimit të vitit 2014, e krijuar për këtë qëllim;
- pagesat për dëmet pezull do të kryhen sipas vitit të ndodhjes, duke ndjekur parimin që më parë të kryhet pagesa për ngjarjen më të hershme të dëmit të ndodhur, dhe do të përballoheshin nga kontributet e shoqërive të sigurimit sipas peshës së tyre në treg për produktin TPL për vitin parardhës bazuar në konceptin e nenit 45 të ligjit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit.

Zbatimi i kësaj mase stabilizuese është monitoruar çdo muaj nga ana e AMF-së. Sipas informacionit të marrë nga BSHS, pagesat e dëmeve objekti i Fondit të Kompensimit në vitin 2015 u realizuan në masën 94%. Këto pagesa lidhen me praktikatat e fondit të kompensimit me

ngjarje sigurimit deri më 31.12.2013. Shkaku i mosplotësimit të detyrimit të përcaktuar në Vendimin e Bordit është se dy shoqëri sigurimi, kanë ankimuar në gjykatë ndarjen e vlerës së detyrimit për fond kompensimi, proces i cili ka përfunduar së shqyrtuari nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në muajin dhjetor 2015. Pavarësisht këtij procesi nga ana e Autoritetit është kërkuar që këto shoqëri sigurimi të përmbushin detyrimin dhe vetëm me përfundimin e procesit gjyqësor me vendim të formës së prerë, do të rivlerësohen shumat e paguara. *(pikë e rezolutës)*

(Në përfundim të gjykimit me vendimin Nr. 10259 datë 28.12.2015 gjykata ka vendosur rrëzimin e padisë të shoqërive palë paditëse, si të pambështetur në ligj dhe në prova.

Aktualisht shoqëritë e mësipërme, kanë paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Apelit, ankim ndaj vendimit gjyqësor nr. 10259, datë 28.12.2015, dhënë nga Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Për sa më sipër çështja ndodhet në Gjykatën Administrative të Apelit ku pritet të gjykohet.

Pavarësisht zhvillimit të këtij procesi, Autoriteti në Janar 2016, për mosplotësim të detyrimit të Fondit të Kompensimit të vitit 2015, në kundërshtim me pikën 2, të nenit 45, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, ka sanksionuar me gjobë Drejtorët e Përgjithshëm të këtyre shoqërive. Gjobat janë derdhur nga ana e tyre brenda afateve të përcaktuara në nenin 259, të Ligjit nr. 52/2014).

AMF ka patur në vëmendje dhe plotësimin e detyrimeve të BSHS-së, lidhur me monitorimin e saj, nga Këshilli i Byrove Bruksel, (COB). Edhe për vitin 2015, BSHS, ka plotësuar kushtet të cilat konsistojnë në: *risigurimin* të një broker i përzgjedhur dhe kontrata e risigurimit është lidhur në përputhje me rekomandimet e COB, si dhe ekzistenca e *garancisë bankare* në favor të Këshillit të Byrove. BSHS informon periodikisht Këshillin e Byrove për stabilitetin e tregut të sigurimit motorik si dhe pagesat e menjëhershme të dëmeve që rrjedhin nga kontrata e sigurimit karton jeshil. Gjithashtu, Byroja informon çdo muaj Autoritetin për thirrjet e garancisë që raportohen nga COB. Gjatë vitit 2015, pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimit janë raportuar 8 thirrje garancie, të cilat janë paguar brenda afateve ose janë në proces pagese (përkatesisht 1 thirrje garancie nga Byroja e Rumanisë, 1 thirrje nga Byroja e Belgjikës, 2 thirrje nga Byroja e Zvicrës, të cilat janë paguar brenda afateve të Rregulloren e Këshillit të Byrove, ndërsa 4 thirrjet e Byrosë Greke, janë raportuar në muajin dhjetor 2015, për të cilat ka vijuar procesi për pagesë. Për thirrjet e garancive të raportuara në muajin Dhjetor 2015, ka përfunduar procesi i pagesave në Mars 2016. Aktualisht nuk ka asnjë thirrje garancie të raportuar në sistemin online të COB).

Viti 2015, iu dedikua thellësisht rolit rregullator në fushën e sigurimeve. Disa nga zhvillimet e rëndësishme lidhur me kuadrin ligjor në fushën e tregut të sigurimeve janë si më poshtë:

- Pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 52/2014, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti vijoi punën *për hartimin dhe miratimin e akteve në zbatim të këtij ligji*. Gjatë 2015, u hartuan dhe u miratuan 18 rregullore. Ndër këto mund të përmendim rregulloren për “*Rregullat e organizimit të sistemit të administrimit të rrezikut në shoqërinë e sigurimit*” (nr. 18 datë 28.04.2015), ku për herë të parë i kërkohej shoqërive të sigurimit të ndërtojnë një *sistem efektiv për administrimin e rrezikut*, bazuar në

natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarisë që ushtrojnë. Gjithashtu, me qëllim të vendosjes së kritereve (*fit&proper*) të strukturave drejtuese të shoqërive të sigurimit që kanë në fokus integritetin, profesionalizmin dhe aftësinë u hartua dhe miratua rregullorja “Për procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrjes, administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve të shoqërisë së sigurimit” (nr. 137, datë 21.12.2015) Në këtë mënyrë është synuar rritja e shkallës së përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së personave të cilët administrojnë dhe drejtojnë shoqëritë e sigurimit. Mjaft e rëndësishme ishte dhe rregullorja e hartuar për herë të parë dhe që lidhet ngushtë me informimin e publikut dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorit, rregullorja “Për informimin e të siguruarit apo personave të tjerë të interesuar për sa u përket zhvillimeve dhe ndryshimeve ligjore në sektorin e sigurimeve” (nr. 36, datë 28.05.2015), e cila përcakton rregullat për informimin e të siguruarit apo personave të tjerë të interesuar për zhvillimet dhe ndryshimet ligjore. Shoqëritë e sigurimit, gjatë vitit 2015, kanë përgatitur dhe raportuar për herë të parë në AMF planin e testimit të vetëvlerësimit sipas kërkesave të reja rregullative. Shoqëritë e sigurimit kanë dorëzuar këtë dokument dhe AMF po vlerëson përmbajtjen e tij.

- U përgatiten ndryshime të ligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” (nr. 10076, datë 12.02.2009), në zbatim të rekomandimeve të Progres Raporteve të BE-së, rekomandimeve të Nënkomitetit Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca, si dhe rekomandimeve të dhëna nga misioni i përbashkët Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore në kuadër të programit të vlerësimit të sektorit financiar (FSAP). Gjatë procesit të hartimit të draftligjit, Autoriteti ka bashkëpunuar ngushtësisht dhe në vazhdimësi me të gjithë aktorët e interesuar. Pas rishqyrtimeve të komenteve dhe sugjerimeve të parashtruara nga Banka Botërore dhe përfshirja e dispozitave të reja në lidhje me strukturimin, funksionim dhe organizimin e Byrosë Shqiptare të Sigurimeve dhe administimin e Fondit të Kompensimit, projektligji do të dërgohet përsëri në Ministrinë e Financave për të vazhduar procesin e miratimit të tij në vitin 2016. (*pikë e rezolutës*)
- Ndryshime në trajtimin fiskal të produkteve të sigurimit, si rezultat i miratimit të paketës fiskale për vitin 2015. Primet e sigurimeve u përjashtuan nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe u aplikua taksa kombëtare në masën 3% mbi primet e shkruara, me përjashtim të primeve për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil. Këto ndryshime për këtë vit nuk patën efekt në çmimin e produkteve të sigurimit dhe kryesisht në sigurimin e detyrueshëm motorik. (*Gjatë vitit 2016 në paketën e re fiskale taksa kombëtare nga 3 % u rrit në 10%*).

Në funksion të rolit të vet mbikëqyrës dhe në zbatim të dispozitave të ligjit të ri për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit (nr. 52/2014), AMF:

- Vijoi me aplikimin e Metodologjisë së Mbikëqyrjes me Bazë Rreziku, zbatimi i të cilës përbën një sfidë jo vetëm për tregun e sigurimeve, por edhe për Autoritetin. Sipas kësaj Metodologjie, AMF ka kryer inspektim në dy shoqëri sigurimi (në njërën shoqëri inspektimi ka filluar në vitin 2014 dhe përfunduar në shkurt të vitit 2015). Këto inspektime u përqëndruan jo vetëm në vlerësimin e situatës financiare, identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të pranishme në shoqëritë e sigurimit sipas aktiviteteve të biznesit, por edhe në inspektimin e procedurave të brendshme të shoqërive të sigurimit që kanë të bëjnë me trajtimin e dëmeve, vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe strategjitë apo kontrollet që ndjek shoqëria për zbutjen e rreziqeve. Në lidhje me procedurat e brendshme të shoqërisë që lidhen me trajtimin e dëmeve, AMF ka patur në vëmendje dhe zbatimin nga ana e shoqërive të sigurimit të procedurave të brendshme të zgjidhjes së ankesave apo zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve midis palëve (risi e ligjit nr. 52/2014). (*pikë e rezolutës*)
- Në kuadër të realizimit të *inspektimeve tematike* është realizuar inspektimi pranë shoqërive të sigurimit të jo-jetës dhe Byrosë Shqiptare të Sigurimit (BSHS) me fokus verifikimin e pagesave të kryera gjatë viteve 2014 dhe 2015 për dëmet e prapambetura të Fondit të Kompensimit me ngjarje sigurimi deri në 31.12.2013 si dhe ato të ndodhura pas datës 1 janar 2014.
- Në zbatim të Ligjit 52/2014 “Për shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit” dhe në kuadër të *bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave*, AMF ka kryer gjatë vitit 2015, dy *inspektime të përbashkëta*. Një në shoqëri sigurimi jetë dhe një në shoqëri risigurimi. Fokusi i inspektimit ishin verifikimet lidhur me respektimin e kuadrit ligjor në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe masat kundër financimit të terrorizmit.

Në drejtim të zhvillimit dhe zgjerimit të tregut të sigurimeve në funksion të mbrojtjes së konsumatorit AMF:

- Realizoi kërkimin në lidhje me mundësinë e *shtrirjes së sigurimit të detyrueshëm edhe në produktet e përgjegjësisë profesionale*, të cilin ia vuri në dispozicion institucioneve përkatëse dhe shoqatës së siguroesve. Referuar standardeve evropiane dhe ndërkombëtare, krahas analizës së thelluar në ndikimin social dhe ekonomik që mund të kenë këto produkte, tregu i sigurimeve me qëllim që iniciativa për bërjen e detyrueshme të disa lloj sigurimesh të ketë sukses, duhet të plotësojë një sërë parakushtesh (si: (i) stabiliteti i tregut i mbështetur nga të dhëna të mjaftueshme të dëmeve; (ii) kapacitete të konsiderueshme për të menaxhuar dhe mbuluar dëmet; (iii) shumëllojshmëri siguroesish për të siguruar konkurrence të ndershme dhe jo zvogëlim të saj në mënyrë të panevojshme; (iv) karakteristika uniforme të riskut, të cilat ndihmojnë në standardizimin e tij; (v) një treg të përshtatshëm risigurimi për të ofruar siguri të mjaftueshme financiare për siguroesit).

- U ngrit komiteti këshillimor me qëllim draftimin e një dokumenti për zhvillimin strategjik të tregut të sigurimeve (VB nr. 33 datë 28.05.2015 dhe nr. 107, datë 05.10.2015).

3. Tregu i letrave me vlerë

Ndërkohë tregu i fondeve të investimeve, në lekë dhe në euro, ka vijuar dinamikën e zgjerimit, duke u shndërruar në tregun e dytë më të madh financiar pas tregut bankar, nga pikëpamja e aseteve. Vlera neto e aseteve të tyre arriti në 66.99 miliardë lekë (479 milionë euro), që përfaqëson 4.7% të PBB-së, nga 4.6% në vitin 2014. Numri i anëtarëve të të dy fondeve është 32,149 ose rreth 1.59% më pak se një vit më parë.

Dinamika e zgjerimit të këtyre fondeve është rritur me rreth 5.1% kundrejt 2014, duke treguar interesin që kanë **investitorët vendas për produkte të reja kursimi apo investimi**. Një situatë e tillë favorizohet edhe nga mjedisi me norma të ulëta të interesit, që zbatohen për produktet bankare të kursimeve, mjedis i cili është mbizotërues prej disa vitesh. Nga kjo pikëpamje, kjo dinamikë zgjerimi është e mirëpritur, sepse nxit zhvillimin e tregjeve financiare, por njëherësh krijon sfida të rëndësishme për t'u përballuar.

Me qëllim administrimin sa më të mirë të ketij zgjerimi në funksion të një mbikëqyrje efektive krahas ngrijës së strukturave organizative të dedikuara, jemi në kontakt të vazhdueshëm me BB dhe FMN për diskutimin e problematikave dhe konsultimin e vazhdueshëm të veprimeve, si edhe me anëtarët e GKSF-së, përkatësisht Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave.

Në këtë kuadër, AMF që nga vitin 2014 po *përmirëson bazën rregullatore* për fondet e investimeve me **dy objektiva kryesorë**: (i) forcimin e regjimit të transparencës ndaj klientit/investitorit (*në mbështetje të këtij objektivi gjatë vitit 2014 u miratuan ose amenduan 4 rregullore*); dhe (ii) përmirësimin e kërkesave për administrimin e riskut në treg. Në vitin 2015, në përmbushje të objektivit të dytë, u miratuan rregullorja për *administrimin e likuiditetit* dhe u amendua rregullorja për *vlerësimin e aseteve të fondeve*. Miratimi i këtyre dy rregulloreve shënoi përmbushjen e rekomandimeve në kuadër të misionit të asistencës teknike të BB dhe FMN. (Të dy rregulloret paraprakisht janë diskutuar dhe konsultuar me institucionet ndërkombëtare BB dhe FMN, me industrinë, Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave).

Nëpërmjet rregullores së *administrimit të likuiditetit* kërkohet që shoqëritë e administrimit të fondeve të investimeve të ngrenë një sistem të përshtatshëm për administrimin e likuiditetit dhe procedura efikase për mbikëqyrjen e rrezikut të likuiditetit, për t'u siguruar që strategjia e investimit, profili i likuiditetit dhe politika e shlyerjes për secilin nga fondet që administrojnë janë në përputhje me detyrimet bazë. Risi e këtij regjimi është përfshirja në kriteret e likuiditetit të

konceptit të tregtueshmërisë së titujve të portofolit të investimit, si dhe e masës së likuiditetit që duhet të mbajë shoqëria administruese në kushtet e veprimit në një treg aktiv apo jo aktiv.

Për një vlerësim më të drejtë të asetëve të fondeve ekzistuese të investimeve, vecanërisht të portofolit që përbehet nga asetë të një tregu joaktiv, u amendua rregullorja *mbi përcaktimin e vlerës së asetëve të sipërmarrjeve të investimit kolektive*. Ky amendim konsistoi në përcaktimin e kushteve të tregut aktiv dhe joaktiv, përcaktimin e metodologjisë për vlerësimin e asetëve që veprojnë në një treg joaktiv dhe marrjen e masave për fondet ekzistuese drejt rivlerësimit të asetëve sipas kushteve të reja rregullatore.

Po në kuadër të përmbushjes së *objektivit të dytë*, u punua për draftimin e disa amendimeve të ligjit bazë, *“Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”* (nr. 10198, datë 10.12.2009), të cilat u miratuan nga Kuvendi i Shqipërisë në seancën plenare të datës 31.03.2016, të cilat parashikojnë detyrimin e shoqërisë administruese për krijimin e një sistemi dhe zbatimin e procedurave të përshtatshme për administrimin e rrezikut, si dhe saktësimin e kompetencave të Autoritetit për të vendosur rregulla në kuadër të administrimit të rrezikut. Gjithashtu, amendimet konsistuan në përmirësimin e regjimit të pezullimit të shlyerjes dhe shitjes së kuotave dhe, veçanërisht në saktësimin e kompetencave të Autoritetit në raste të jashtëzakonshme kur pezullimi arsyetohet duke mbajtur parasysh interesat e mbajtësve të kuotave.

Në funksion të rolit të vet mbikëqyrës:

- AMF dhe Banka e Shqipërisë, në përmbushje të rekomandimeve të FSAP-it për një *mbikëqyrje efektive të konsoliduar*, kryen inspektim të përbashkët pranë shoqërisë administruese të fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive me objekt verifikimin e procedurave të brendshme, sistemeve, llogaritjen e vlerës neto të asetëve të fondeve të investimeve dhe pensioneve si dhe procedurat e rakordimit të kësaj vlere me bankën depozitare.
- AMF ka kryer *inspektim tematik* pranë personave të autorizuar për shitjen e kuotave të fondeve të investimeve lidhur me zbatimin e kuadrit rregullator për transparencën dhe regjimin e informimit, në shitjen e kuotave të fondeve të investimit tek investitorët, si dhe pranë shoqërisë administruese lidhur me zbatimin e rregulloreve të reja (*“Për administrimin e likuiditetit për fondin e investimeve” dhe “Mbi përcaktimin e vlerës së asetëve të sipërmarrjeve të investimit kolektiv dhe llogaritjen e vlerës neto të asetëve të tyre për kuotë”*).

Investimi nëpërmjet *platformave të tregtimit online* përbën një risi për tregun shqiptar. Duke vlerësuar rrezikun që mbart investimi në këto platforma, Autoriteti ka synuar në rregullimin e veprimtarisë së subjekteve që promovojnë produktet e platformave online duke i kushtuar rëndësi *transparencës dhe ndërgjegjësimit të publikut* për t’iu drejtuar vetëm subjekteve të

licencuara. Në këtë kuadër, Autoriteti ka rritur nivelin e bashkëpunimit si me institucionet brenda ashtu dhe me autoritete të tjera relevante të huaja për shkëmbimin e informacionit.

Gjatë vitit 2015, kanë vepruar 2 subjekte të licencuar si *agjentë të shoqërive të huaja të brokerimit*, që administrojnë platformat përkatëse. Gjatë këtij viti, nëpërmjet këtyre subjekteve të licencuara janë përfshirë rreth 250 investitorë, duke investuar mbi 1 milion USD.

4. Tregu i fondeve të pensioneve private

Tregu i pensioneve ka shfaqur një dinamikë me të lartë rritjeje, veçanërisht në lidhje me numrin e anëtarëve. Gjatë vitit 2015, totali i asetëve neto të fondeve të pensioneve private arriti në 930 milionë lekë (6.77 milionë euro), me një rritje prej afro 47.62% krahasuar me vitin 2014 (në 2014 rritja ishte 44.7%), si dhe një numër anëtarësh prej 12,559 ose 47.91% më tepër se në vitin 2014 (në 2014 rritja ishte 7.7%).

Ky zhvillim pa dyshim, është edhe efekt i **përfshirjes së nxitësve të përshtatshëm fiskalë**. Me miratimin e paketës fiskale të vitit 2015, u bë e mundur zbatimi i lehtësive fiskale për anëtarët e fondeve të pensionit, ku si kontributi i anëtarit në fond, ashtu edhe kontributet e punëdhënësit konsiderohen të ardhura të përjashtuara për efekt tatimi deri në kufirin e përcaktuar nga Ligji për pensionet. Po kështu, kthimi nga investimi i realizuar nga fondi i pensionit është i përjashtuar nga tatim-fitimi.

Gjithsesi, zhvillimi në tërësi i tregut të fondeve të pensioneve **kërkon** dhe një sërë faktorësh të tjerë nxitës, që nga **formalizimi i ekonomisë deri te elementët e ndërgjegjësimit të kontribuesve, punëdhënës e punëmarrës**. Keto ishin dhe konkluzionet e studimit të realizuar në kuadër të projektit të BB për mbikëqyrjen dhe zgjerimin e tregut të pensioneve private vullnetare në vend.

Si pjesë e projektit, në bashkëpunim me INSTAT dhe BB u krye vrojtimi për vlerësimin e qëndrimeve të punëdhënësve ndaj ofertës së planeve të pensionit profesional, dhe si rezultat u formuluan disa konkluzione të rëndësishme për organizimin e fushatave *edukuese dhe promovuese* për të nxitur interesin për produktet e tregut të pensioneve private dhe për zhvillimin në tërësi të këtij tregu. Rezultatet e vrojtimit iu bënë të njohura publikut në një konferencë të organizuar në kuadër të projektit (*në muajin tetor 2015, konferenca “Sistemi i pensioneve vullnetare në Shqipëri – zgjerimi i mbulimit”*).

Po në kuadër të projektit të asistencës së BB, u përgatit drafti i *Manualit të mbikëqyrjes me bazë rreziku për tregun e pensioneve*, si dhe u draftuan amendimet e ligjit “*Për fondet e pensionit vullnetar*” (nr. 10197, datë 10.12.2009), të cilat synojnë të rritet shkalla e përafrimit të ligjit me

direktivat e BE-së, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit. Në këtë kuadër iniciativa e ndërmarrë nga Autoriteti, përmirëson dhe plotëson kuadrin ligjor në tregun e pensioneve vullnetare sipas modelit evropian dhe praktikave më të mira ndërkombëtare. Këto amendime pritet të miratohen në Kuvend gjatë vitit 2016.

5. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Në zbatim dhe me hapësirën e krijuar nga miratimi i paketës ligjore për AMF:

- U konstitua Bordi i AMF, i përbërë nga pesë anëtarë, i cili përgjatë 2015 ushtroi veprimtarinë me një anëtar më pak, anëtar i cili u miratua vetëm në fund të janarit 2016.
- U ndërmorrën ndryshime strukturore dhe organizative të nevojshme për t'iu përshtatur prirjeve të zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje. Struktura e re organizative e miratuar (VB nr. 27, datë 28.04.2015 “Për miratimin e strukturës organizative, numrin e punonjësve dhe përshkrimet e punës së AMF”) u ndërtua drejt theksimit të tiparit vertikal (sipas tregjeve) në fushën e mbikëqyrjes, por duke ruajtur thelbin e ndarjes horizontale (sipas funksioneve) në fushën e licencimit dhe rregullimit. Po ashtu, në mbështetje edhe të ligjit të ri mbi veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit u ngrit si strukturë më vete Qendra e Edukimit, me qëllim organizimin e trajnimeve të nevojshme për formimin dhe kualifikimin profesional të drejtuesve dhe profesionistëve të cilët operojnë në tregun e sigurimeve (aktuarë, broker, vlerësues dëmsh), por edhe të organizimit të trajnimeve për rritjen e kapaciteteve të punonjësve të AMF, me prespektivën për zgjerimin e aktivitetit edhe në dy tregjet e tjera në vitet e ardhshme. (Qendra Edukimit gjatë vitit 2015 ka trajnuar 78 profesionistë të tregut të sigurimeve).
- U rrit në strukturë organizative numri i të punësuarve, veçanërisht në sektorin e mbikëqyrjes në përmbushje të objektivit të rritjes së kapaciteteve mbikëqyrëse si një nga prioritetet e vendosura. Në këtë mënyrë u realizua punësimi eksperteve me përvojë pune në tregun bankar, të sigurimeve apo shoqërive audituese, dhe që posedonin njohuri dhe aftësi shumë të mira profesionale, etikë dhe integritet të lartë. Punësimi i stafit të ri dhe të kualifikuar vazhdon të jetë përparësi në kuadrin e politikave të burimeve njerëzore dhe përmirësimit të cilësisë së punës në institucion, duke iu përgjigjur zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje. (Gjatë vitit 2015 numri i të punësuarve u rrit me 10 punonjës, 5 prej të cilëve të dedikuar në funksionet e mbikëqyrjes dhe pjesa tjetër në funksionet rregulluese dhe të administrimit.)
- U miratua udhëzimi për pagat dhe shpërblimet (Udhëzim “Për shpërblimet e anëtarëve jo-ekzekutivë dhe pagat e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, Nëndrejtorit Ekzekutiv dhe të punonjësve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 76, datë 28.07.2015), me objektivin e tërheqjes dhe mbajtjes së stafit të kualifikuar. Tabela e re e pagave dhe shpërblimeve është konkurrese dhe produkt i një diskutimi të

gjerë me ekspertet e misionit të BB dhe FMN, si dhe mbështetur në praktikën e rregullatorit të sistemit bankar.

Një aspekt i rëndësishëm i veprimtarisë së AMF-së janë angazhimi në kuadër të marrëdhënieve me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe angazhimi me projektet e asistencës teknike. Autoriteti është pjesë aktive e komiteteve dhe nënkomiteteve apo organeve të tjera në kuadër të tre organizatave ndërkombëtare të mbikëqyrësve të tregjeve të sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve, përkatësisht IAIS, IOSCO dhe IOPS. Me këto organizata ka edhe një marrëdhënie intensive në përgatitjen e dokumentave të ndryshëm, politikë, studimorë, pyetësorë etj.

Mjaft i rëndësishëm ishte nënshkrimi i *marrëveshjes se bashkëpunimit me Institutin dhe Fakultetin e Aktuarëve në Londër dhe Shoqatën Shqiptare të Aktuarëve*, me qëllim krijimin e bazave të bashkëpunimit për programet e trajnimit dhe kualifikimit profesional për aktuar, training i cili nisi në shtator të 2015 dhe pritet të përfundojë në muajin korrik 2017.

Autoriteti i Mbikëqyrjes së Austrisë (FMA), si dhe autoritete të tjera të mbikëqyrjes të rajonit të Europës Lindore e Qendrore, si ai i Sllovenisë, Maqedonisë, Kosovës por edhe të tjera si Autoriteti Federal i Mbikëqyrjes Financiare (Bafin) të Gjermanisë, përbëjnë një grup autoritetesh mbikëqyrëse e rregullatore me të cilat AMF ka marrëdhënie të vazhdueshme dypalëshe dhe në kuadër inisiativash të grupeve në funksion të forcimit të kapaciteteve dhe të shkëmbimit të përvojës. Me FMA-në marrëdhëniet zhvillohen edhe në kuadër të Kolegjeve Mbikëqyrëse të Grupeve të Sigurimit të Austrisë. Bordi Mbikëqyrës i EIOPA-s³ në Shkurt 2016 miratoi vlerësimin e regjimit të sekretit profesional të AMF-së. Si rrjedhojë e vlerësimit pozitiv të këtij regjimi nga EIOPA, AMF mund të jetë pjesë e Kolegjeve Mbikëqyrëse të Grupeve të Sigurimit të vendeve të BE-së dhe më konkretisht atyre të Austrisë.

Në vitin 2015, AMF organizoi *workshopin "Mbikëqyrja dhe rregullimi i tregjeve të letrave me vlerë dhe fondeve të investimeve në Shqipëri"* me përfaqësues nga Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursës së Maqedonisë, si dhe *tryezën e rrumbullakët "Mbështetja e bashkëpunimit rajonal për mbikëqyrjen ndërkufitare dhe të grupeve në sigurime"*. Aktiviteti u organizua në bashkëpunim me Trupën Vullnetare të Shërbimeve Financiare të USAID me pjesëmarrjen dhe kontributin e përfaqësuesve të lartë të autoriteteve homologe, mbikëqyrëse të sektorit të sigurimeve nga vendet e Evropës Qendrore e Juglindore, si Austria, Maqedonia, Kosova, Mali i Zi, Republika Serbe e Bosnjë-Hercegovinës dhe Sllovenia.

³ European Insurance and Occupational Pensions Authority (Autoriteti Rregullator Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale)

Në kuadrin e bashkëpunimit me institucione brenda vendit mund të përmendim, bashkëpunimin dypalësh ndërmjet AMF-së dhe Bankës së Shqipërisë, Ministrisë së Financave dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, si dhe bashkëpunimi shumëpalësh ndërmjet tyre në kuadër të Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF), në funksion edhe të zbatimit të rekomandimeve të FSAP-it, veçanërisht atyre që lidhen me fushat e veprimit të këtyre institucioneve, siç ishin paketat ligjore; trajtimi fiskal i produkteve të sigurimeve dhe të pensioneve; si dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPP), me të cilën nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi informacioni.

Në funksion të forcimit të tregut të sigurimeve, dhe veçanërisht për sigurimin e detyrueshëm motorik, AMF ka punuar ngushtësisht me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit si edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor. Po ashtu AMF ka nisur një bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë në kuadër të “Projektit pilot për krijimin dhe eksperimentimin e një sistemi sigurimesh të lehtësuara për mbulimin e rreziqeve në bujqësi” dhe është pjesë e grupeve të punës.

Në vitin 2015 AMF vijoi me projektet e asistencës teknike në funksion të forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse e rregullatore të AMF-së për secilin prej tregjeve që mbikëqyr.

Më konkretisht për ecurinë e secilit projekt gjatë 2015 dhe çfarë do të realizohet deri në përmbylljen e tyre:

Projekti i asistencës teknike për reformën në tregun e sigurimeve me një kohëzgjatje fillestare prej 24 muajsh, kohë e cila është kërkuar të shtyhet nga Banka Botërore deri më 31 mars 2017, i strukturuar në tre komponentë kryesorë, vijoi me përmbushjen e detyrave dhe realizimi përkatës është si vijon:

1. *Sigurimi i produktit MTPL.* Ky komponent është fokusuar në zhvillimin e metodologjive të përshtatshme për përcaktimin e provigjoneve teknike për produktin MTPL mbi baza aktuariale të shëndosha. Bazuar në të dhënat historike të zhvillimit të dëmeve është punuar dhe në drejtim të organizimit të bazës së të dhënave për të hartuar mbi këtë bazë kërkesat rregullatore të përditësuara për përcaktimin e provigjoneve teknike për produktin MTPL, dhe për t'i inkuadruar ato me praktikatat e mbikëqyrjes. Gjithashtu është përditësuar kuadri rregullator lidhur me kriteret e risigurimit. Baza rregullatore dhe modelet përkatëse priten të finalizohen dhe miratohen gjatë vitit 2016.
2. *Mbikëqyrja e përgjithshme e sigurimeve.* Ky komponent me objektiv forcimin e kapacitetit mbikëqyrës të AMF-së është fokusuar në përgatitjen e manualeve të mbikëqyrjes tematike dhe bazës rregullatore në bazë të standardeve ndërkombëtare dhe të përshtatura për kushtet e tregut shqiptar. Në kuadrin e krijimit të një mbikëqyrjeje të

kujdesshme të sigurimit të jetës është punuar me parimet aktuariale dhe rregullat për përcaktimin e provigjoneve matematike; aktivet në mbulim të provigjoneve matematike; mbrojtjen e konsumatorit në kontratat e sigurimit të jetës. Këto koncepte së bashku me manualet e mbikëqyrjes së sigurimeve të jetës dhe jo-jetës do të finalizohen në një kuadër të miratuar rregullativ në vitet 2016-2017.

3. *Programi kombëtar i sigurimit nga tërmetet.* Eshtë vijuar me hartimin e ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga katastrofat (*tërmetet dhe përmbytjet*) dhe diskutimin e tij me shoqëritë e sigurimit. BB ka realizuar takime me grupe të interesit përfshi Ministrinë e Financave, shoqëritë e sigurimit, etj. Ky komponent do të vijojë gjatë 2016 dhe 2017.

Projekti i asistencës teknike për zgjerimin e tregut dhe mbikëqyrjen e pensioneve me një kohëzgjatje prej 18 muajsh dhe i strukturuar në dy komponentë kryesorë, vijoi me përbushjen e detyrave dhe realizimi përkatës është si më poshtë:

1. *Rregullimi dhe mbikëqyrja.* Në lidhje me këtë komponent, grupi i punës i ngritur në AMF për këtë qëllim gjatë vitit 2015 ka punuar për hartimin manualit të mbikëqyrjes me bazë rreziku, si elementi bazë për zbatimin e kësaj metodologjie mbikëqyrjeje në fushën e pensioneve; si dhe përgatitjen e amendimeve të ligjit për pensionet private në frymën e kësaj metodologjie. Në vitin 2016 objektivat e projektit lidhen me trajnimin e punonjësve të AMF-së për përdorimin në praktikë të manualit, vlerësimin e rreziqeve në tregun e pensioneve dhe kryerjen e inspektimeve pilot sipas metodologjisë së re në bashkëpunim me ekspertët e BB. Manuali i mbikëqyrjes me bazë rreziku si dhe paketa e amendimeve të ligjit të fondit të pensionit vullnetar pritet të miratohen gjatë 2016.
2. *Zgjerimi i tregut të pensioneve.* Përsa i takon këtij komponenti një hap i rëndësishëm u hodh me mbajtjen në tetor 2015 të Konferencës “Sistemi i pensioneve vullnetare në Shqipëri – Zgjerimi i mbulimit”, e cila shërbeu si një forum për diskutimin e problematikave që kanë të bëjnë me zhvillimin e këtij tregu. Gjithashtu, gjatë vitit 2015 në bashkëpunim me INSTAT, u krye vrojtimi për vlerësimin e qëndrimeve të punëdhënësve ndaj ofertës së planeve të pensionit profesional. Vrojtimi u krye në të gjithë territorin e vendit me punëdhënësit me mbi 20 të punësuar. Rezultatet e vrojtimit, si dhe diskutimet e zhvilluara në konferencë mbështetën hartimin e strategjisë dhe të planit të veprimit për zgjerimin e tregut të pensioneve. Kjo strategji ka filluar të zbatohet në vitin 2016, duke u fokusuar në rritjen e shkallës së njohurive përmes takimeve me punëdhënësit, median, rritjen e shkallës së njohurive përmes fushatave edukuese me publikun, si dhe marrjen e masave për të forcuar besimin e publikut në AMF dhe në sektorin financiar në tërësi.

Projekti i asistencës teknike për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse me fokus zhvillimin e tregut të kapitaleve ka një kohëzgjatje prej 36 muajsh dhe është strukturuar në dy komponentë kryesorë, si më poshtë:

1. *Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së për mbikëqyrjen dhe rregullimin e fondeve të investimeve* synon të kryhen vlerësimet diagnostikuese, të zhvillohet paketa e mbikëqyrjes (metodologjia, manualët dhe mjetet), si dhe zhvillimi i burimeve njerëzore.
2. *Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së për t'u përgatitur për emetimet e obligacioneve të shoqërive aksionare dhe atyre të qeverisë vendore* synon të kryhen vlerësimet diagnostikuese, si dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në fushën e instrumenteve dhe tregjeve të borxhit.

Gjatë 2015, në bashkëpunim me Bankën Botërore, Sekretariatën Shtetërorë Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe Qeverinë Shqiptare, AMF ka ndjekur procedurat përgatitore për nisjen e këtij projekti. Kështu krahas procedurave për miratimin e marrëveshjes së grantit nga ana e Qeverisë Shqiptare, u përgatitën termat e referencës së projektit. Projekti pritet të fillojë së shpejti.

6. Objektiva dhe projekte të ardhshme, 2016-2017

Së pari, objektivi i rëndësishëm mbetet *realizimi me sukses i tre projekteve të asistencës teknike*. Të tre projektet kanë komponent të rëndësishëm rishikimin e bazës ligjore për tregjet që mbikëqyrin. AMF ka përfunduar me amendimin e ligjit për fondet e pensionit vullnetar dhe po punon me atë të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, me synim miratimin e tyre në vitin 2016. Ligje të tjera, kryesisht ato që kanë të bëjnë me tregun e kapitaleve, do të shikohen në vitet pasuese, në kuadër edhe të projektit SECO. E përmenda këtë fakt për të sjellë në vëmendjen tuaj që pëmbushja me sukses e detyrave të projekteve do të kërkojë në vitin 2016 e në vijimësi mbështetjen e Kuvendit në procesin e diskutimit dhe miratimit të ligjeve me synim nxitjen e stabilitetit financiar dhe mbrojtjen e konsumatorëve.

Me konkretisht *përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator* në përputhje me direktivat e BE-së dhe standardet ndërkombëtare, si dhe rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes, do të konsistojë në

- ndjekja e procesit të ndryshimeve të ligjit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit dhe përfundimi i procesit të hartimit të rregulloreve në zbatim të Ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”;
- ndjekja e procesit të miratimit të ndryshimeve në ligjin për fondet e pensionit vullnetar si dhe hartimin e manualit të mbikëqyrjes me fokus rrezikun;
- hartimi i kuadrit rregullator sipas praktikave ndërkombëtare në zbatim të ndryshimeve në ligjin e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive.

Së dyti, objektiv i rëndësishëm është *studimi dhe ndërtimi i një strategjie për zgjerimin e tregut të sigurimeve*, bashkëpunimi me grupet e interesit, ministritë e linjes, institucionet ndërkombëtare. Kjo edhe në funksion të ndërgjegjësimit të publikut, reduktimit të riskut nga katastrofat natyrore, përmbytjet, tërmetet, aksidentet, pergjegjësitë publike, profesionale, etj.

Së treti,

- *për tregun e sigurimeve vëmendja do të vijojë të përqendrohet ne masat stabilizuese, ku përfshihen: (i) masa e stabilizimit të financimit dhe përmirësimit të administrimit të fondit të kompensimit; (ii) masa e mbajtjes së rezervës monetare në shoqëritë e sigurimit. Të dyja këto masa stabilizuese kanë për qëllim edhe përmirësimin e pagesave për palët përfituese, në përfitim të konsumatorëve. (iii) Adresimi i mbikëqyrjes së grupeve; (iv) shtrirja e mbikëqyrjes me fokus riskun në pjesën më të madhe të shoqërive të sigurimit; (v) testimi i sistemit të vlerësimit të administrimit të rrezikut nga shoqëritë e sigurimit, do të përbëjnë prioritete të punës së AMF përse i përket këtij tregu gjithashtu;*
- *ndërsa për dy tregjet e tjera sfida të rëndësishme për AMF për vitin 2016 do të jenë: (i) zbatimi i mbikëqyrjes me bazë rrezikun në tregun e fondeve të investimeve dhe fondeve të pensioneve vullnetare; (ii) nxitjen e qëndrueshmërisë në tregjet financiare, nëpërmjet përmirësimit të procesit të mbikëqyrjes së konsoliduar dhe forcimit të rregullave të administrimit të rrezikut; dhe (iii) forcimin e punës së AMF-së në drejtim të mbrojtjes dhe edukimit të konsumatorit, përmes zbatimit të strategjisë së edukimit të investitorëve të SIK dhe të anëtarëve potenciale të fondeve të pensioneve.*

Së katërti, një objektiv i rëndësishëm do të jetë edhe vazhdimi i rritjes dhe forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF në periudhë afatmesme, i cili pritët të realizohet përmes (i) zbatimit të projekteve të asistencës teknike (ii) plotësimit të vendeve vakante nëpërmjet punësimit të burimeve cilësore të punës; (iii) përshtatja e strukturës organizative zhvillimeve të tregjeve; (iv) trainimit të burimeve njerëzore, me qëllim rritjen e ekspertizës profesionale të tyre; dhe (v) trajtimin më të mirë financiar të tyre, me qëllim ruajtjen dhe motivimin e burimeve cilësore.

Duke Ju falenderuar për vëmendjen tuaj,

Sfida dhe projekte të ardhshme, 2016-2017

Në thelb drejtimit kryesore për zhvillim dhe sfidat e rëndësishme për AMF-në për vitin 2016-2017 në lidhje me tregjet financiare që mbikëqyrën, mbeten të përqendruara te:

- Zbatimi i mbikëqyrjes me fokus rrezikun, jo vetëm në tregun e sigurimeve, por edhe shtrirjen e kësaj metodologjie në tregun e fondeve të investimeve dhe fondeve të pensioneve vullnetare private;
- Nxitja e qëndrueshmërisë së tregjeve financiare, nëpërmjet përmirësimit të procesit të mbikëqyrjes së konsoliduar;
- Forcimi i punës së AMF-së në drejtim të mbrojtjes dhe edukimit të konsumatorit.

Brenda këtij kuadri të përgjithshëm, AMF për çdo vit zhvillon dhe përmirëson aspekte të ndryshme, që synojnë përmbushjen e objektivave kryesore.

Gjatë vitit 2016 vëmendja do të vijojë të përqendrohet në *stabilizimin e tregjeve dhe mbikëqyrjen me fokus riskun* ku përfshihen specifikisht (i) masa e stabilizimit të financimit dhe përmirësimit të administrimit të fondit të kompensimit; (ii) masa e mbajtjes së rezervës monetare në shoqëritë e sigurimit; (iii) hartimi dhe zbatimi i strategjisë së edukimit të investitorëve të SIK; (iv) shtrirja e mbikëqyrjes me fokus riskun në të gjitha shoqëritë e sigurimeve; (v) forcimi i rregullave të administrimit të rrezikut të fondeve të investimeve; (vi) adresimi i mbikëqyrjes së grupeve; (vii) testimi për ndërtimin e sistemit të administrimit dhe vlerësimit të rrezikut nga shoqëritë e sigurimeve në bashkëpunim dhe nën orientimin e AMF-së

Nxitja e zhvillimit dhe qëndrueshmërisë së tregjeve financiare nën mbikëqyrje, pritet të mbështetet nga masat që do të çojnë në shtim të ofertës së produkteve dhe përafrimit me standardet ndërkombëtare në aktivitetin e mbikëqyrjes. Në vijim, AMF po ofron bashkëpunimin me institucione të tjera të qeverisë për hartimin e legjislacioneve përkatëse për zgjerimin e gamës së produkteve në fushën e sigurimeve. Në fushën e pensioneve vullnetare po shqyrtohen mënyrat për rritjen e ndërgjegjësimit të punëdhënësve dhe punëmarrësve për të përdorur produktet që ofron tregu i pensioneve vullnetare. Ndërsa në fushën e fondeve të investimeve, AMF po ndjek me kujdes administrimin e rrezikut të likuiditetit, vlerësimin real të asetëve, si dhe përmirësimin e komunikimit e të informimit të investitorëve. Gjithashtu, AMF ka si objektiv hartimin e protokollit të mbikëqyrjes së përbashkët me Bankën e Shqipërisë për të mundur mbikëqyrjen e konsoliduar në ato veprimtari të institucioneve financiare ku përgjegjësia mbikëqyrëse është e të dy autoriteteve. Me përmbushjen e këtij objektiv synohet të reduktohen mundësitë e transferimit të rreziqeve nga një segment në një tjetër të sistemit financiar, apo që rreziqe të caktuara që mbeten pa u mbikëqyrur. Pra në thelb kontribuohet në rritjen e qëndrueshmërisë financiare.

Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator vijon të jetë një objektiv i rëndësishëm, me synim rritjen e shkallës së përafrimit me direktivat e BE-së dhe standardet ndërkombëtare, si dhe rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes. Në tregun e sigurimeve, AMF do vijojë punën për ndjekjen e procesit të ndryshimeve të ligjit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, si dhe përfundimin e procesit të hartimit të rregulloreve në zbatim të Ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. Përsa i takon tregut të pensioneve vullnetare, AMF do të ndjekë procesin të miratimit të ndryshimeve në ligjin për pensionet si dhe hartimin e manualit të mbikëqyrjes me fokus rrezikun që përfshin hapat e identifikimit, përkufizimit, klasifikimit dhe reagimit të rreziqeve në këtë treg. Në fushën e fondeve të investimeve, AMF do të punojë për hartimin e kuadrit rregullator sipas praktikave ndërkombëtare në zbatim të ndryshimeve në ligjin e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive.

Në tërësi, vëmendja do të jetë në **forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse** në periudhë afatmesme, e cila pritet të realizohet përmes (i) plotësimit të vendeve të lira sipas strukturës organizative të AMF-së në përputhje me zhvillimet e tregut dhe punësimin e burimeve njerëzore sa më cilësore; (ii) kualifikimit profesional i stafit të AMF-së, me qëllim rritjen e ekspertizës profesionale në punë; (iii) trajtimit i punonjësve të AMF-së, për të mbështetur rritjen e cilësisë së tyre.

Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse do të përmbushet edhe nga zbatimi i tre projekteve të asistencës teknike që ka përfutur AMF nga Banka Botërore, për të tre tregjet që mbikëqyren dhe më konkretisht:

- Projekti i asistencës teknike për reformën në tregun e sigurimeve;
- Projekti i asistencës teknike për zgjerimin e tregut dhe mbikëqyrjen e fondeve të pensioneve;
- Projekti i asistencës teknike për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse me fokus zhvillimin e tregut të kapitaleve.

Projekti i asistencës teknike për reformën në tregun e sigurimeve. Projekti ka një kohëzgjatje prej 24 muajsh, kohë e cila është kërkuar të zgjatet nga Banka Botërore, dhe është strukturuar në tre komponentë kryesorë, si më poshtë:

1. **Sigurimi i produktit MTPL.** Në këtë komponent synohet të hartohen kërkesa rregullatore për përcaktimin e rezervave për produktin MTPL, që janë të përshtatshme nga ana aktuariale dhe për t'i inkuadruar ato me praktikatat e mbikëqyrjes në vend. Objektivat e këtij komponenti janë: (i) të sigurohet për konsumatorët kryerja e pagesave të duhura dhe në kohë në lidhje me dëmet për produktin MTPL; (ii) të ndiqen të njëjtat standarde në sigurimin MTPL; dhe (iii) të sigurohet vlerësim i përshtatshëm i aftësinë paguese për të gjitha shoqëritë e sigurimit.
2. **Mbikëqyrja e sigurimeve të përgjithshme.** Në këtë komponent synohet zhvillimi i kuadrit ligjor në zbatim të ligjit të miratuar për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit, paketës

së manualeve të mbikëqyrjes në vend dhe kuadrit rregullator për sigurimin e jetës. Objektivi i këtij komponenti është forcimi i kapacitetit mbikëqyrës institucional të AMF-së. Ky komponent fokusohet në veprimtarinë e sigurimit të jetës dhe në këtë aspekt u punua me parimet aktuariale dhe rregullat për përcaktimin e provigjoneve matematike; aktivet në mbulim të provigjoneve matematike; mbrojtjen e konsumatorit në kontratat e sigurimit të jetës. Këto koncepte së bashku me manualët e mbikëqyrjes së sigurimeve të jetës dhe të jo jetës do të përfundohen në një kuadër të miratuar rregullativ në vitin 2016.

3. *Programi kombëtar i sigurimit nga tërmetet.* Në këtë komponent synohet plotësimi i bazës ligjore dhe rregullatore me elementët e sigurimit nga tërmeti dhe përmbytja. Në bashkëpunim me Bankën Botërore, pritet të vijojë puna së bashku me palët e tjera të interesit për hartimin e këtij ligji.

Projekti i asistencës teknike për zgjerimin e tregut dhe mbikëqyrjen e pensioneve. Projekti ka një kohëzgjatje prej 18 muajsh dhe është strukturuar në dy komponentë kryesorë, si më poshtë:

1. *Rregullimi dhe mbikëqyrja.* Në këtë komponent objektivi është të hartohet kuadri i mbikëqyrjes me bazë rrezikun, si elementi bazë për zbatimin e kësaj metodologjie mbikëqyrjeje në fushën e pensioneve, si dhe përgatitjen e amendimeve të ligjit për pensionet private në frymën e kësaj metodologjie.

Në vitin 2016 objektivat e projektit lidhen me trajnimin e punonjësve të AMF-së për përdorimin në praktikë të manualit, vlerësimin e rreziqeve në tregun e pensioneve dhe kryerjen e inspektimeve pilot sipas metodologjisë së re në bashkëpunim me ekspertët e BB.

2. *Zgjerimi i tregut të pensioneve.* Objektivi në këtë komponent është zgjerimi i mbulimit me pensione të punëmarrësve në Shqipëri. Gjatë vitit 2016 do të vijohet me hartimin dhe zbatimin e strategjisë të mbështetur në rezultatet e vrojtimit dhe të planit të veprimit për zgjerimin e tregut të pensioneve, të publikuar gjatë Konferencës “Sistemi i pensioneve vullnetare në Shqipëri – Zgjerimi i mbulimit”, organizuar nga AMF dhe Banka Botërore. Kjo strategji fokusohet në rritjen e shkallës së njohurive përmes takimeve me punëdhënës, rritjen e shkallës së njohurive përmes fushatave edukuese me publikun, si dhe marrjen e masave për të forcuar besimin e publikut në AMF dhe në sektorin financiar në tërësi. Edukimi i vazhdueshëm i publikut në lidhje me rëndësinë e zgjerimit të tregut të pensioneve private vullnetare mbetet një nga prioritetet kryesore në funksion të zgjerimit të mëtejshëm të këtij tregu.

Projekti i asistencës teknike për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse me fokus zhvillimin e tregut të kapitaleve. Projekti ka një kohëzgjatje prej 36 muajsh dhe është strukturuar në dy komponentë kryesorë, si më poshtë:

1. *Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së për mbikëqyrjen dhe rregullimin e fondeve të investimeve.* Në këtë komponent synohet të kryhen vlerësimet diagnostikuese, të zhvillohet paketa e mbikëqyrjes (metodologjia, manualët dhe mjetet), si dhe zhvillimi i burimeve njerëzore;
2. *Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së për t'u përgatitur për emetimet e obligacioneve të shoqërive aksionare dhe atyre të qeverisë vendore.* Në këtë komponent synohet të kryhen vlerësimet diagnostikuese, si dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në fushën e instrumenteve dhe tregjeve të borxhit.

Gjatë vitit 2016 pritet të fillojë zbatimi i komponentit të parë, konkretisht me dy nën komponentët përkatës:

- Vlerësimi i strukturës, stafit dhe nevojave të trajnimit lidhur me fushën e mbikëqyrjes së fondeve të investimit;
- Vlerësimi dhe zhvillimi i legjislacionit dhe paketës mbikëqyrëse për fondet e investimit dhe obligacionet e shoqërive dhe qeverive lokale.

Sistemi i Menaxhimit të Informacionit. Zbatimi i metodologjisë së re të mbikëqyrjes me fokus rreziku kërkon mbështetje teknologjike. Në këto kushte prioritet i AMF do të jetë zhvillimi i formateve të reja në sistemin AMF In-Reg, në zbatim të metodologjisë së re të mbikëqyrjes dhe të dedikuara për mbikëqyrjen me fokus rreziku. Gjithashtu në fokus të AMF do të jetë dhe shtrirja e kësaj platforme të raportimit elektronik edhe në segmente të tjera të tregjeve financiare, si në tregun e letrave me vlerë dhe pensioneve private.